



FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
DEPARTAMENTI I MATEMATIKËS

CIKLI II MASTER I SHKENCAVE NË MATEMATIKË
PROGRAMI I LËNDËS: GJUHË E HUAJ 1

Aktiviteti mësimor	Leksione	Ushtrime	Laboratore	Praktike	Totale
Detyrimi i studentit	Jo të detyrueshëm	75%			
Orë mësimore		45			45
Studim individuale	60				
Gjuha e zhvillimit të mëimit	Gjuhe angleze				
Tipologjia e lëndës / Lloji i lëndës/ Kodi i lëndës	E / E detyrueshme				
Kodi i etikës	Referuar Kodit të etikës së UT, miratuar me Vendim Nr. 12, datë 18.04.2011				
Mënyra e shlyerjes	VLV				
Kredite	5				
Zhvillimi i Mëimit	SEM 1/ 2 Lek + 2 sem / 15 jave				
Zhvillimi i Provimit	Vlerësim i vazhduar				
Vlerësimi, Nota VLV	Pjesëmarrja dhe aktivizimi			10%	
	Detyra kursi			30%	
	Laboratore				
	Kontrolle 1			20%	
	Kontrolle 2			20%	
	Kontrolle 3			20%	
	Gjithsej			100 %	

Konceptet themelore	<p>Programi i këtij moduli iu ofron studenteve një qasje të re ndaj mëimit të gjuhës angleze: Gjuha Angleze në mësimdhënien e Matematikës. Kjo qasje merr në fokus studentin dhe nevojat e tij specifike. Moduli ka si synim zhvillimin e aftësisë së studenteve për të njohur, kuptuar dhe përdorur anglishten profesionale në të dyja formatet: të folur dhe të shkruar. Gjithashtu, moduli synon të sigurojë një bazë solide për terminologjinë me qëllim pasurimin e njohurive të anglishtes në fushën e <i>Matematikës</i>. Ky modul është i hartuar me qëllim që:</p> <p>Të përmbushë standardet sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës për Gjuhët. T'u mundësojë studenteve përvetësimin e katër aftësive kryesore: të lexuarit, të shkruarit, të folurit dhe të dëgjuarit me qëllim rritjen e fjalorit teknik dhe shkencor të fushës, zhvillimin e aftësive diskutuese dhe përmirësimin e aftësive prezantuese.</p> <p>Te shprehurit në mënyre të qarte dhe koncize të ideve në të folur dhe në të shkruar.</p>
Objektivat	<p>Objektivat e kursit përfshijnë: -Përmirësimin e kompetencave komunikuese të studentëve në situata të ndryshme profesionale. -Përfshirjen e studenteve në procesin e të mësuarit aktiv</p> <p>Përfitim të kompetencave gramatikore dhe leksikore përmes leximit dhe analizimit të teksteve tekniko-shkencore. -Përqendrimin në gramatikë dhe përcaktimin me saktësi të strukturave gramatikore në tekstet shkencore duke eksploruar me detaje struktura themelore gramatikore. -Ndërthurjen e komunikimit dhe termave shkencore teknike në situata të jetës së përditshme. -Eksplorimin e teksteve me detaje dhe trajtimin e analizës së teksteve sipas aspekteve morfologjike duke u përqendruar në formimin e fjalëve. -Te kërkuarit për informacion të vlefshëm në një tekst shkencor. - Përkthimin me saktësi të termave dhe teksteve në gjuhën që mësohet. -Nxitjen e komunikimit në anglisht në fushën tekniko-shkencore për t'u dhënë mundësi studenteve të integrohen në tregun e punës ku anglishtja e bujqësisë/mjedisit është domosdoshmëri.</p>
Njohuritë paraprake	Niveli b2/c1 i anglishtes globale nga ekspozimi në vitin 1 dhe të 2 bachelor.